



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No. 01-060-01-5535-24

Nr. i fq. / Br. str. / No. pg.

Data / Datum / Date 21.02.2024

OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.31.01.2024, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Labinot Mirena (IQO), Vlora Mjekiqi Kabashi (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala (IQO), Florije Jashari (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Ajshe Haliti Pllana (LVV), Albanë Shillova Shalaku (LVV), Valon Svirca (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Linda Sadiku Krasniqi (LDK), Bajram Hashani (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristic (SL) dhe Biljana Spasic(SL).

Të pranishmit tjerë: Ibush Mjekiqi, Nënkyetar i Komunës, drejtorët komunal, Ganimete Aliu, zyrtare për barazi gjinore Festina Preniqi, zyrtare për marrëdhënie me publikun

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Raportit të Kuvendit Komunal për vitin 2023
4. Raporti financiar i shpenzimeve janar – dhjetor 2023
5. Shqyrtimi i Planit të Punës të Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit Komunal për vitin 2024 dhe Planifikimi Përfundimtar i Prokurimit
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme

Kryesuesja – Më lejoni, që fillimisht të ju falënderoj për bashkëpunimin e treguar për vitin 2023 për nxjerrjen e shumë vendimeve, Planeve dhe Rregulloreve, njëherit ju uroj shëndet dhe mbarësi gjatë vitit 2024.

Kryesuesja i njoftoi të pranishmit me rendin e ditës i cili u miratua me 19 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Kryesuesja – Të nderuar anëtarë të Kuvendit komunal, kësaj radhe materialin e keni pranuar pak më ndryshe se herave tjera, sepse tani administrata komunale ka ndryshuar në sistemin e protokollimit të dokumenteve dhe juve materiali iu ka ardhë i bashkëngjitur si në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhën serbe.

Sami Ahmeti – Duke pasë parasysh se në seancën e kaluar kemi pasë probleme teknike, procesverbali nuk është i plotë së paku te pjesët e mia, vërej se nuk përkon ajo që thuhet edhe përkundër asaj që znj. Azize na ka kërkuar me shkrim që me i dërgue fjalimet tona. Do të thotë unë nuk kam pasë mundësi me i transkriptue ato për shkak të disa obligimeve tjera. Sido që të jetë procesverbali konsiderohet si procesverbal jo i plotë dhe nuk përkon komplet me realitetin çka kemi folë. Ne në këtë rast do të votojmë kundër.

Kryesuesja – Ne gjatë mbledhjes kemi tregue se kemi probleme teknike dhe bashkëpunëtorja ka kërkuar nga ju që procesverbali të plotësohet, kështu që shkojmë me votim.

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 12 vota për 4 vota kundër dhe 3 vota abstenim.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Ju raportin e Kuvendit Komunal për vitin 2023 e keni pranuar. Në raport janë paraqitë 12 mbledhje të rregullta të mbajtura, 3 mbledhje të jashtëzakonshme dhe 2 mbledhje solemne. Gjatë vitit 2023 Kuvendi Komunal ka nxjerrë 66 vendime, ndërsa 4 prej tyre janë kthyer për shfuqizim. Vendimet për shfuqizim kanë qenë 3 vendime për emërtimet e rrugëve dhe një vendim i “Bermas Therm”. Ne e kemi aprovuar Planin për menaxhimin e mbeturinave 2023-2028, Planin për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Obiliqit 2023-2025, Plani i veprimit për transparencë 2023-2027, Planin lokal të veprimit për cilësi të ajrit, Planin e punës së Kuvendit Komunal për vitin 2024, Strategjinë për zhvillim socio-ekonomik lokal 2023-2027 dhe Planin lokal të veprimit për barazi gjinore për vitin 2024-2026.

Enver Gashi – Fillimisht edhe unë unë i uroj anëtarëve të Kuvendit një vit të mbarë dhe të suksesshëm siç e kemi pasë edhe vitin paraprak. Sa i përket raportit të Kuvendit Komunal, ne si grup parlamentar nuk kemi se çka të shtojmë, është i paraqitur me kohë dhe i përgëzoj ata që e kanë punue, suksese.

Sami Ahmeti – Çdo raport që e prezenton punën e secilës instancë duhet të jetë i mirëseardhur. Për mendimin tonë dhe neve si grup i anëtarëve të LVV-së, ky raport duket se më shumë ka referenca të LVV-së, se sa që mund të quhet raport. Në vend të citimit të këtyre neneve dhe ligjeve ka qenë mirë të evidentohen të gjitha ato vendime, Rregullore dhe rekomandime që i nxjerrë Kuvendi. Pastaj të cekën se cilat nga ato vendime apo Rregullore po implementohen sepse shumë prej tyre ne i kemi miratue, por disa prej tyre edhe nuk po implementohen. Nëse, jemi këtu për me votue si makina pa i mbikëqyrë ato vendime, nuk e di a ia vlen që jemi këtu, nuk e di a ia vlen edhe pse LVV-ja, na i ka rritë pagat për 300 %. Thjeshtë, ky raport nuk më duket që është raport, është një shkresë orientuese për të treguar punën që e bën Kuvendi Komunal, bazën ligjore mbi të cilën ai funksionon, por jo edhe thelbin e asaj për çka jemi dhe çka bëjmë. Unë e di që ky raport nuk votohet, por do të ishte mirë që kur të na prezantohen dokumentet ato të jenë përmbajtësore.

Kryesuesja – Në raportin e Kuvendit Komunal për vitin 2022 kanë qenë për çdo muaj datat e mbajtjes së Komitetit dhe mbledhjeve si dhe cilat vendime janë marrë gjatë atij muaji. Pasi e kemi paraqitë raportin, në Kuvendin Komunal, është thënë se nuk ka nevojë, është material voluminoz dhe ne e dijmë se kur janë mbajtë mbledhjet. Për këtë arsye jam tërheqë sepse ne i kemi të gatshme, do të thotë e kemi listën e vendimeve për çdo mbledhje nga se çdo 3 muaj i raportojmë edhe MAPL-së.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën e DEFZH-së, për raportin financiar të shpenzimeve janar-dhjetor 2023.

Enver Gashi – Unë e përgëzoj raportin e Kuvendit Komunal që është me kohë, njësoj edhe DEFZH-në, e përgëzoj sepse është një raport që brenda janarit menjëherë pas përfundimit të vitit kalendarik 2023 e ka sjellë raportin financiar të shpenzimeve. Ne si grup nuk kemi ndonjë vërejtje.

Sami Ahmeti – E thamë edhe në mbledhjen e KPF-së, se ne e kemi pranuar raportin dhe jemi dakord që ai të kaloj në seancën e Kuvendit Komunal. Po ashtu, e thamë se i kemi disa pyetje dhe komente në fakt për çka kisha pasë dëshirë të kemi edhe përgjegje. Te të hyrat vetanake janë radhitur 13 burime të të hyrave, ndërsa totali në fund figuron 97 euro e 38 për dallim që do të duhej të ishte mbi 2 milionë, që mendoj se është dashtë me shkrue përqindjen. Te të hyrat vetanake, te të hyrat nga tatimi në pronë figurojnë 449,465.92 euro, a janë këto të hyra jashtë asaj që janë mbuluar me vendimin e Kuvendit Komunal për faljen e deri 100 eurove të tatimit në pronë. Te pagat dhe meditet çka do të thotë shifra apo fondi 10 që janë paraparë dhe ekzekutuar rreth 5.1 milionë dhe shifra ose fondi 21 që janë paraparë dhe ekzekutuar 63,999 euro. Nga mallrat dhe shërbimet nga 1 milionë e 500,000 euro, për Arsim janë shpenzuar treqind e tre mijë euro, në ndërkohë që shkollat përballen me mungesat esenciale të materialeve higjienike dhe administrative. Do të ishte mirë të na tregoni se ku janë shkue këto mjete. Raporti si raport e ka vetëm shifrën e përgjithshme. Te mallrat dhe shërbimet ceket se Kuvendi Komunal ka harxhuar 8,000 euro, brenda vitit 2023 dhe kisha pasë dëshirë me na shpjegue dikush ku harxhohen këto mjete kur ne kërrojmë çka harxhojmë është një shishe ujë brenda një mbledhje të Kuvendit Komunal dhe nëse e mbledhim me të gjitha punët që bën Kuvendi Komunal 500 shishe ujë kushtojnë 150 euro. E di që Kuvendi ka edhe aktivitete tjera, ka edhe trupa tjerë që rrjedhin prej Kuvendit Komunal, por kishim pasë dëshirë me qenë më transparente se a po raportohet saktë dhe ku po harxhohen ato mjete, përfshirë drekat dhe darkat që iu shtrohen Ekzekutivit nga ky fond. Në këtë raport nuk përfshihen, do të thotë nuk kemi asnjë informatë që tregon për faljen apo shlyerjen e deri 100 euro të tatimit në pronë, prandaj është mirë të na tregohet se sa i ka kushtuar kjo buxhetit komunal, që do të ishte mirë të ishte përfshirë në këtë raport. Këto, janë disa nga vërejtjet edhe pse kemi ende më shumë, por duke pasë parasysh ndodhë që të jetë e pamundur që të përgjegjen për momentin ndalemi këtu nëse, drejtoresha ka mundësi me u përgjegjë mirë e nëse, jo prapë nuk është problem se jemi mësue.

Ajet Berisha – Është një raport financiar që tregon shpenzimin e mirë të buxhetit në të gjitha kategoritë e veta, kështu që ju përgëzoj juve, si staf që keni qenë përgjegjës për me i shpenzue këto mjete. Duke filluar në pjesën në të cilën jo vetëm ky raport, por secili prej raporteve ka mangësi në raportimin korrekt të shpenzimeve në kuptimin e asaj që ne me ditë si anëtarë të Kuvendit Komunal shpenzimi në subvencion ku ka shkue dhe për kend ka shkue. Do të thotë janë elemente bazike po e marrë ndarja e subvencioneve që këtu, vetëm flet për secilin sektor administrata 100,000 Kryetari 100,000 bujqësia 500,000 do të thotë nuk ka një specifikacion të asaj se kujt iu kanë dhënë, ku janë shkue dhe për çka janë shkue. Edhe pse kishte dalë një raport më i gjerë edhe në mallra dhe shërbime, është dashur disa specifika shembull kur thotë se i ka harxhue Kuvendi 8,000 euro me specifikue dhe kjo vlen për të gjitha kategoritë janë kjo, kjo e kjo me këtë përqindje që ne ta kuptojmë më saktë mënyrën e shpenzimit. Unë për vete jam shumë i interesuar me pa këtë lloj të shpenzimit. Te investimet kapitale u bë për çdo vit ndoshta i treti apo i katërti për çdo vit sheshi “Adem Preniqi” ka shpenzime 200,000 euro, kur praktikisht unë çdo ditë kaloj andej dhe pothuajse 90 % e ndriçimit në atë shesh nuk funksionon. Cilat janë këto investime të përvitshme në këtë shesh, që ne si qytetarë nuk po i vërejnë dhe unë jam shumë i interesuar me ditë. Shpenzimi dikund nga 540,000 euro, që i bjen afërsisht dikund 8.5, 9 % të shpenzimit për investime kapitale është i regjistruar vetëm si bashkëfinancim. Në rast se ai shpenzim është bashkëfinancim në çfarë përqindje është ky bashkëfinancim, me kend është dhe në çka kanë shkue këto shpenzime. Do të thotë është një raport korrekt, transparentë për me kuptue ne edhe llojin e investimit, edhe mënyrën e subvencionimit dhe njerëzit që i kemi subvencionue kompanitë apo organizatat e ndryshme. Për me qenë më korrekt mendoj se ky raport financiar është dashur me qenë pak më detal në kuptimin e asaj që dikush nuk përton me i lexue dhe i shfleton ndërsa, si tërësi si shpenzim unë jam i kënaqur me këtë menaxhim të buxhetit me shpenzim po flas. Mirëpo, me transparencën mënyrën e raportimit nuk jam i kënaqur sepse ka shumë të panjohura prandaj, ju lus që

herave tjera, merrne mundin edhe te subvencionet edhe te lloji i shpenzimeve tjera, jepni pak disa specifika bazë që ne me ditë orientimin se ku kanë shkue këto mjete.

Ibush Mjekiqi – Fillimisht ju falenderoj për punën që e keni bërë në vitin e kaluar dhe falë punës së juaj si Kuvend është ky rezultat i shpenzimit të buxhetit. Mirëpo, këtu duhet falenderuar edhe stafin zyrtar komunal si dhe Ekzekutivin, që kemi ardhë deri në këtë shpenzim i cili ka qenë një ndër shpenzimet më të mira prej se qeverisim në këtë 10 vjeçar. Mendoj se raporti financiar është një raport i detajuar, por sido që të jetë për specifikat e shpenzimeve është raporti vjetor i punës së Kryetarit, ku secila Drejtori specifikisht e paraqetë se ku janë shpenzue mjetet, duke u bazuar në të gjitha kategoritë buxhetore. Prandaj kur të vjen në Kuvend ky raport i punës së Kryetarit për vitin 2023 mund të bisedohet për të gjitha këto që i cekën parafolësit. Edhe sot nuk është e keqe nëse, bisedojmë për këtë çështje dhe ne jemi këtu, e jo vetëm ne si Ekzekutiv por edhe ju si të zgjedhur të dijmë saktësisht jo vetëm për 8,000 euro, por edhe për një euro ose një shumë e caktuar e mjeteve se ku është duke shkue. Mendoj se viti 2023 në raportin e shpenzimit financiar ka qenë shumë i mirë dhe shpenzimi është qysh e keni në raport. Sa i përket bashkëfinancimit në vitin e kaluar kemi qenë në mesin e Komunave me performancën më të mirë dhe si rezultat i kësaj kemi fituar grandin prej 690,000 euro, të cilat janë realizue në Komunën tonë dhe janë të prekshme. Në mesin e tyre është parku në Bakshi, që ka qenë për 3,4 vite për shkak të këmbimit të tokës i vonuar, por në fund i realizuar. Po ashtu, ka edhe projekte tjera por në raportin e punës ishim ndalë në specifikat që sot ju i keni dhënë.

Ajet Berisha – Unë dua ta mbështesë krejtë këtë që e thatë Nënkyetar meqë, dihen saktë për juve, e jo për neve se gjithë ai bashkëfinancim me kend është bërë dhe ku ka shkue, do të thotë është element vetëm pse nuk është pasqyrue sepse nuk ka diçka për me fshehtë, por është dashtë me pasqyrue. Për këtë kjo është vërejtje më e madhe sepse kur keni tendencë me fshehtë kamuflohet diçka, nëse mundet. Unë për këtu, i sigurtë jam që një pjesë për parkun në Bakshi e kam ditë ndërsa, për pjesën tjetër nuk e di edhe me kend kemi bashkëfinancue, sa është përqindja dhe cili është projekti. Mendoj se është mjaft e thjeshtë që këtë me pasqyrue.

Ibush Mjekiqi – Sqaron se janë 3 ose 4 projekte të realizuara me bashkëfinancim që janë nënkalmimet, te parku atje rregullimi i infrastrukturës së rrugëve në Bakshi dhe parkingu te banesat e Hades. Këto, janë prej grandit të performancës bashkë me bashkëfinancim. Po ashtu, ka edhe projekte tjera të realizuara në bujqësi me bashkëfinancim, do të thotë shpenzimi prej kësaj kategorie prekë shumë projekte. Te sheshi “Adem Preniqi” e dini kur e kemi ndërtue këtë sheshin pjesën poshtë këtu, ka mbetë vijë e bashkëfinancimit, por nuk investohet atje dhe e kemi bustin e “Fahri Fazliut” do të thotë krejtë shkon përmes asaj vije.

Sami Ahmeti – Për me ia ndihmue debatit derisa Nënkyetar mirë se na erdhe se pas një kohe të gjatë nuk jemi parë. Pyetjet që i shtrova në rast se vjen raport prej Ekzekutivit apo Kryetarit të Komunës raport i detajuar nuk ka nevojë drejtoresha me na u përgjegjës. Pasi që kanë qenë të përgjegjshëm Drejtoria e financave dhe Kuvendi Komunal, për me na bë raportin qysh në fillim pse Kryetari nuk e ka bërë, atëherë a konsiderohet i papërgjegjshëm me bë raportin për vitin 2023 qysh në mbledhjen e parë. Sido qoftë unë tërhiqem prej pyetjeve që i ngrita në rast se vjen raporti i detajuar. E kemi thënë edhe herave tjera nuk kemi qëllim me lue rolin e hetuesit, jemi anëtarë të Kuvendit Komunal edhe kur kemi pyetje dhe paqartësi është mirë me qenë raporte pak më të kthjellëta sepse jo të gjithë jemi ekonomistë, jo të gjithë e kuptojmë qysh bëhen punët e kontabilitetit, kështu që raportet kur të bëhen duhet të bëhen me i kuptua gjithkush, kjo është me rëndësi. Përndryshe, në atë moment që kemi vërejtje ne normal që i dërgojmë te vendi, por në këtë rast jemi veç për me u sqarue.

Ibush Mjekiqi – Raporti është i gatshëm, por për shkak të mungesës së Kryetarit sot sa për informacion të juaj ai është i ftuar në Shtëpinë e Bardhë për lutjet e mëngjezit, është në Amerikë ndërsa në mbledhjen e radhës do ta keni raportin sepse raporti është i gatshëm që ka mund me qenë edhe në këtë mbledhje.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën për shqyrtimin e Planit të punës të Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit Komunal për vitin 2024 dhe planifikimin përfundimtar të Prokurimit.

Enver Gashi – Ne si grup nuk kemi diçka me plotësue.

Sami Ahmeti – Planin e punës për vitin 2024 pjesërisht e kam lexue, por më ka shti me u kthye dhe me lexue edhe Planin e punës për vitin 2023, që me pa a po ndërlidhen apo a po realizohen këto plane që po ia vendosim vetes. Do të thotë se do të ishte mirë që në kuadër të këtij plani të ishin edhe të arriturat e planit paraprak, mirëpo në momentin që e shehë këtë plan ku si aktivitete për vitin 2024 liston e citoj:” E kemi në plan ofrimin e informatave të duhura për qytetarët, pranimi i të gjitha kërkesave, sistemimi dhe klasifikimi i lëndëve” këto nuk duhet me qenë në plan sepse këto janë obligim, edhe kështu vazhdon lista për 2 faqe radhazi. Mendoj që ky veç plan nuk është, por sido që të jetë ne si anëtarë të LVV-së, urojmë që të zbatohet ky plan ambicioz dhe si rrjedhojë ti ndryshoj shërbimet komunale.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nga MAPL-ja, për rishqyrtimin e vendimit nr.-I-168 për miratimin e Strategjisë për zhvillimin socio-ekonomik lokal të Komunës së Obiliqit 2023-2027. Ne edhe pse e kemi adresue rekomandimin e Ministrisë të Komisioni, nuk kemi pranuar material sipas rekomandimeve të Ministrisë, andaj kërkoj nga ju që të shfuqizohet ky vendim.

Ajet Berisha – Pse këto vendime nuk po na vijnë neve, për shembull e kenë shqyrtimin e kërkesave dhe asnjë kërkesë e deponuar te ne që të dimë me u përgatitë se për çka është fjala. Edhe refuzimi apo rekomandimi nga Ministria, duhet me na ardhë që edhe ne të dimë se ku kemi gabue sepse ne po votojmë ose jo dhe jemi përgjegjës për marrjen e vendimit. Pra, kishte me qenë mirë të dimë se ku po gabojmë, që këto me na i dërgue.

Kryesuesja – I nderuar z.Berisha, këto vinë te kryesuesja dhe te Kryetari, por jo të gjitha edhe te Kryetari drejtëpërsëdrejti edhe nga Ministria dhe Ministria kërkon që të merren veprime të rishqyrtohet vendimi, të harmonizohet sipas legjislacionit në fuqi dhe në fund thotë se është konfidenciale. Asnjëherë nuk kishte qenë praktikë e mëhershme që këto të iu dërgohen anëtarëve të Kuvendit. Në këtë rast është përgjegjësi e kryesueses nëse, ajo don ta fshehtë një rishqyrtim të vendimit dhe nuk e paraqetë para anëtarëve të Kuvendit, atëherë merren masa ndaj kryesueses.

Ajet Berisha – Më fal kryesuese, për përgjegjësinë tënde është e jotja ti guxon, s’guxon është punë për ty, ndërsa për ato që neve na vinë me i miratue dhe me i shfuqizue, ne duhet me pasë materialin. Do të thotë nuk po dua në mënyrë të verbër as me miratue, as me shfuqizue, ose në rast se kemi gabue gjë që është njerëzore gabimi, nuk ia kemi qëllue, nuk e kemi pa një akt, apo një Udhëzim kemi shkue në procedurë jo të rregulltë me ditë ku kemi gabue. Në thelb është diçka jokorrekte dhe nuk mundesh as në emër të konfidencës me u thirrë sepse unë kam me shfuqizue dhe unë kam me miratue, nuk ka konfidencë prej meje në këtë rast. Ky mundet mos me u bë publik ndoshta, këtë nuk e di ndërsa për anëtarët e Kuvendit Komunal, ky është dokument që unë duhet me pasë. Këtë, as mos e diskuto, as mos e vë në dyshim se unë s’kam të drejtë me pasë sikurse ju me të drejta të plota edhe unë kam të drejtë me pasë këtë dokument që me ditë se çka po votojmë, çka po shfuqizojmë edhe ku kemi gabue.

Kryesuesja – Siç e dini mbledhjet janë live dhe unë po e lexoj, por do ta kontaktoj edhe MAPL-në, dhe e di se më kanë thënë më heret se te anëtarët e Kuvendit nuk janë shpërndarë, kështu që unë do të pyes për këtë çështje. Unë po e lexoj ashtu siç është dhe nuk kam asgjë me fshehtë, sigurisht edhe ju mundeni me gjetë nëse kërkonit te Ministria, e cila e ka dërguar.

Sami Ahmeti – Këtë bisedë e kemi pasë edhe në rastet tjera, veç sa për informacionin e juaj. Disa prej këtyre vendimeve unë kam marrë të drejtë vetë në MAPL për shkak edhe të vetë afërsisë së vendit të punës. Ajo që e thatë se është konfidenciale unë konsideroj se mund të jetë konfidenciale për palët tjera, por jo edhe për anëtarët e Kuvendit Komunal. Ju, si kryesuese nuk mundesh vetëm me na lexue atë pjesën që ti e shehë të rëndësishme pa keqkuptime dhe me kërkue me ndryshue një vendim të tërë, ose një Rregullore të tërë apo çkado qoftë për shkak të një paragrafi që ju e lexoni. Do të thotë ajo çka e tha parafolësi qëndron plotësisht dhe kjo nuk është kritikë, por është mirë me u sqarue që kur mbahet

mbledhja e Kuvendit Komunal, anëtarët e tyre duhet me i pasë të gjitha materialet në mënyrë që me arritë me dhënë kontributin. E kuptojmë se shumë herë ka mundësi të bëhen gabime, bëhen gabime gjithandej nëpër institucione të cilat përfundojnë si jo të ligjshme, ose jo në linja ligjore. Sido që të jetë transparenca është shumë e nevojshme nëse, diçka trajtojmë është mirë ta kemi paraprakisht. Përndryshe, veç tregoni kur e votojmë rendin e ditës, i votojmë krejtë përnjëherë dhe shkojmë.

Kryesuesja – Patjetër z.Ahmeti, nuk ka këtu se çka të fshihet sepse unë po e lexoj dhe gjithçka shkon live, inçizohet dhe MAPL-ja, na monitoron në vazhdimësi çdo mbledhje. Ju, e dini se këto, nuk vijnë me materialin që ne e dërgojmë, por munden me ardhë me vonesë, munden me ardhë aty për aty, por siç thashë do të bisedoj dhe nëse, është në rregullë mua aspak nuk më pengon kjo punë për mbledhjet e radhës.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 13 vota për dhe 8 vota abstenim e shfuqizuan e vendimit nr.-I-168, të dt,29.12.2023, për miratimin e Strategjisë për zhvillimin socio-ekonomik lokal 2023-2027.

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nga MMPHI-ja, për rishqyrtimin e vendimit nr.-I-151, të dt.30.11.2023, për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Njësitë Kadastrale në Zonën Kadastrale në Milloshevë dhe Obiliq. Po ashtu, ne kemi pranuar një Propozimvendim nga Drejtoria të përgatitur që ka ardhë pak para se të filloj mbledhja e Kuvendit, ku thuhet se është rregulluar baza ligjore sipas kërkesës së MMPHI-së.

Enver Gashi – Është mirë që këto të ndahen, së pari të votohet shfuqizimi i vendimit sipas kërkesës së MMPHI-së, pastaj e votojmë Propozimvendimin e Drejtorisë.

Sami Ahmeti – E njëjta vlen sikur ajo përpara se nuk kemi dokumente dhe nuk dimë për çka bëhet fjalë. Megjithatë, në lidhje me këtë vendim e kemi biseduar edhe në seancën e nëntorit kur është bërë kjo pikë e rendit të ditës, që do të përfundoj si e tillë. Sa i përket ndryshimeve ligjore nuk mjafton veç me thënë se është ndryshue baza ligjore dhe me i kërkuje Kuvendit, me votue sepse atë duhet me pa anëtarët e Kuvendit. Ne shfuqizimin e votojmë ndërsa, ndryshimet e saj nuk i votojmë.

Ajet Berisha – Në nëntor kemi thënë se kjo do të kthehet si e paligjshme, jo që është dashtë me qenë ndonjëfarë parashikuesi, por e kemi ditë se po ndërhyjmë në një pronë që nuk është edhe baza ligjore dhe të gjitha kemi qenë të qartë se ka me u kthye. Atëherë, kemi abstenuë edhe në propozimin e ri sepse nuk e dimë çka ka. Ne prapë do të abstenojmë dhe nuk do të marrim pjesë në votim fare sepse nuk kemi asnjë shkresë përpara që me ditë se ku jeni bazue, ku është ndryshimi dhe cili është qëllimi.

Shaip Paloja – Në vendimin e Ministrisë përkatëse që ju e lexuat aty lenë me dyshue diçka ose unë nuk e kuptova sepse ne atë pronë nuk e kemi dhënë, por e kemi shpallë zonë me interes publik. Edhe në arsyetimin e Ministrisë thuhet se ato prona ka të drejtë me i dhënë vetëm Qeveria, por ne ato prona nuk ia kemi dhënë askujt, që është e dyshimtë ose konfuze. Arsyetimi është jo i qartë nga Ministria, vetëm e kemi shpallë zonë me interes dhe ato prona kur të vjen koha nëse, ne tentojmë me ia dhënë dikujt në shfrytëzim atëherë biejmë në kundërshtim. Prandaj, arsyetimi i Ministrisë është jo i qartë që unë nuk e kuptoj.

Kryesuesja – Sqaron se te preambula lartë është përfshirë Ligji nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme dhe Ligji nr.03-L-205 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme. Ndërsa, tani është Ligji nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 17 vota për e shfuqizuan Vendimit nr.-I-151, të dt.30.11.2023, për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Njësitë Kadastrale në Zonën Kadastrale në Milloshevë dhe Obiliq.

Kryesuesja – Tani votojmë Propozimvendimin e ri të DPUKP-së, për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Njësitë Kadastrale në Zonën Kadastrale në Milloshevë dhe Obiliq.

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 13 vota për dhe 4 vota kundër morën Vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Njësitë Kadastrale në Zonën Kadastrale në Milloshevë dhe Obiliq.

Kryesuesja – Çdo parcelë e paraqitur në Propozimvendim duhet të votohet dhe shkojmë sipas radhës.
Parcela P-72614055-00066-1, Lloji i Njesisë:Parcelë: Lloji i Pronës: Pronë Shoqërore/R; Lloji i Shfrytëzimit të parcelës: Tokë Tjetër; Shfrytëzimi aktual i parcelës: Jo pjellore; me sipërfaqe prej 136696 m² ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Obiliq; vendi i quajtur: "Aerodrom" e cila evidentohet në emër të KEK Sh.a. ;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 13 vota për dhe 4 vota kundër e miratuan parcelën e cekur më lartë .

Parcela P-72614055-00066-2, Lloji i Njesisë:Parcelë: Lloji i Pronës : Pronë Shoqërore/R; Lloji i Shfrytëzimit të parcelës: Tokë Tjetër; Shfrytëzimi aktual i parcelës: Jo pjellore; me sipërfaqe prej 1470 m² ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Obiliq; vendi i quajtur: "Aerodrom" e cila evidentohet në emër të KEK Sh.a.

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 13 vota për dhe 4 vota kundër e miratuan parcelën e cekur më lartë.

Parcela - P-72614051-00836-3, Lloji i Njesisë: Parcelë: Lloji i Pronës: Pronë Shoqërore/R; Lloji i Shfrytëzimit të parcelës: Bujqësore; Shfrytëzimi aktual i parcelës: Kullosat; kualiteti i klasës: Kullosë e klasës 2; me sipërfaqe prej 408395² ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Milloshëvë; vendi i quajtur:"Njive Kod Aerodr." e cila evidentohet në emër të KEK Sh.a.;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 12 vota për dhe 4 vota kundër e miratuan parcelën e cekur më lartë.

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nga MMPHI-ja, për rishqyrtimin e vendimit nr.-I-152, të dt.30.11.2023, për shpalljem me interes të përgjithshëm publik për Njësitë Kadastrale në Zonën Kadastrale në Llazarevë dhe Milloshevë.

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 18 vota për e Shfuqizuan Vendimin nr.-I-152, të dt.30.11.2023, për shpalljem me interes të përgjithshëm publik për Njësitë Kadastrale në Zonën Kadastrale në Llazarevë dhe Milloshevë.

Kryesuesja - Tani e votojmë Propozimvendimin e ri të DPUKP-së, për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Njësitë Kadastrale në Zonën Kadastrale në Llazarevë dhe Milloshevë.

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 12 vota për dhe 3 vota kundër morën Vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Njësitë Kadastrale në Zonën Kadastrale në Llazarevë dhe Milloshevë.

Kryesuesja – Po ashtu, e kemi votimin e parcelave sipas radhës:

Parcela P-72614041-00024-1, Tipi i pronës/Lloji i Pronës: Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa :Bujqësore- Arat– Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 7353 m² ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë ;vendi i quajtur:Fusha e Këthjellët e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA ;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 12 vota për dhe 3 vota kundër e miratuan parcelën e cekur më lartë.

Parcela P-72614041-00024-2, Tipi i pronës/Lloji i Pronës : Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa: Bujqësore- Arat – Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 4552 m² ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë; vendi i quajtur: Fusha e Këthjellët e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA ;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 12 vota për dhe 4 vota kundër e miratuan parcelën e cekur më lartë.

Parcela P-72614041-00025-1, Tipi i pronës/Lloji i Pronës: Pronë Private/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa:Bujqësore- Arat – Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 5517 m² ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë ;vendi i quajtur:Fusha e Këthjellët e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA ;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 12 vota për dhe 4 vota kundër e miratuan parcelën e cekur më lartë.

Parcela P-72614041-00025-2, Tipi i pronës/Lloji i Pronës: Pronë Private/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa :Bujqësore- Arat – Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 2600 m² ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë; vendi i quajtur:Fusha e Këthjellët e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA ;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 12 vota për dhe 4 vota kundër e miratuan parcelën e cekur më lartë.

Parcela P-72614041-00025-3, Tipi i pronës/Lloji i Pronës: Pronë Private/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa: Bujqësore- Arat – Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 1187 m² ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.

Ël Lazarevë; vendi i quajtur: Fusha e Këthjellët e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA ;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 11 vota për dhe 4 vota kundër e miratuan parcelën e cekur më lartë.

Parcela P-72614041-00025-4, Tipi i pronës/Lloji i Pronës: Pronë Private/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa: Bujqësore - Arat – Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 2931 m² ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë; vendi i quajtur: Fusha e Këthjellët e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA ;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 11 vota për dhe 4 vota kundër e miratuan parcelën e cekur më lartë.

Parcela P-72614041-00026-1, Tipi i pronës/Lloji i Pronës: Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa: Bujqësore- Arat– Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 10890 m² ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë ;vendi i quajtur:Fusha e Këthjellët e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA ;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 12 vota për dhe 4 vota kundër e miratuan parcelën e cekur më lartë.

Parcela P-72614041-00026-2, Tipi i pronës/Lloji i Pronës: Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa :Bujqësore- Arat – Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 3996 m² ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë ; vendi i quajtur:Fusha e Këthjellët e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA ;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 11 vota për dhe 4 vota kundër e miratuan parcelën e cekur më lartë.

Parcela P-72614041-00027-1, Tipi i pronës/Lloji i Pronës: Pronë Private/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa :Bujqësore- Arat – Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 15431 m² ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë; vendi i quajtur: Fusha e Këthjellët e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA ;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 11 vota për dhe 4 vota kundër e miratuan parcelën e cekur më lartë.

Parcela P-72614041-00027-2, Tipi i pronës/Lloji i Pronës : Pronë Private/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa :Bujqësore - Arat – Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 1726 m² ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë ;vendi i quajtur: Fusha e Këthjellët e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA ;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 12 vota për dhe 4 vota kundër e miratuan parcelën e cekur më lartë.

Parcela P-72614041-00028-0, Tipi i pronës/Lloji i Pronës: Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa :Bujqësore- Arat – Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 19022 m² ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë; vendi i quajtur:Fusha e Këthjellët e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA ;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 12 vota për dhe 4 vota kundër e miratuan parcelën e cekur më lartë.

Parcela P-72614041-00031-0, Tipi i pronës/Lloji i Pronës: Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa: Bujqësore- Arat – Arë e klasës 4; me sipërfaqe prej 13884 m² ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë ;vendi i quajtur: Tërshevina e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA ;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 12 vota për dhe 4 vota kundër e miratuan parcelën e cekur më lartë.

Parcela P-72614041-00032-1, Tipi i pronës/Lloji i Pronës: Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa: Bujqësore - Arat – Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 37414 m² ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë; vendi i quajtur: Tërshevina e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA ;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 11 vota për dhe 4 vota kundër e miratuan parcelën e cekur më lartë.

Parcela P-72614041-00032-2, Tipi i pronës/Lloji i Pronës : Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa: Bujqësore - Arat– Arë e klasës 4; me sipërfaqe prej 22218 m² ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë ;vendi i quajtur: Tërshevina e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA ;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 12 vota për dhe 4 vota kundër e miratuan parcelën e cekur më lartë.

Parcela P-72614041-00033-0, Tipi i pronës/Lloji i Pronës : Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa :Bujqësore – Arat – Arë e klasës 4; me sipërfaqe prej 30795 m² ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë ;vendi i quajtur: Tërshevina e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA ;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 12 vota për dhe 4 vota kundër e miratuan parcelën e cekur më lartë.

Parcela P-72614041-00034-1, Tipi i pronës/Lloji i Pronës: Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa: Bujqësore – Arat – Arë e klasës 4; me sipërfaqe prej 20000 m² ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë; vendi i quajtur: Tërshevina e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA ;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 12 vota për dhe 4 vota kundër e miratuan parcelën e cekur më lartë.

Parcela P-72614041-00035-1, Tipi i pronës/Lloji i Pronës: Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa: Bujqësore – Arat – Arë e klasës 4; me sipërfaqe prej 36096 m² ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë; vendi i quajtur: Fusha e Hapur e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA ;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 12 vota për dhe 4 vota kundër e miratuan parcelën e cekur më lartë.

Parcela P-72614041-00035-2, Tipi i pronës/Lloji i Pronës : Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa :Bujqësore – Arat – Arë e klasës 4; me sipërfaqe prej 10155 m² ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë; vendi i quajtur:Fusha e Hapur e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA ;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 12 vota për dhe 4 vota kundër e miratuan parcelën e cekur më lartë.

Parcela P-72614041-00036-1, Tipi i pronës/Lloji i Pronës : Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa: Bujqësore – Arat – Arë e klasës 3; me sipërfaqe prej 5994 m² ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë ;vendi i quajtur:Tërshevina te Llazareva e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA ;

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 12 vota për dhe 4 vota kundër e miratuan parcelën e cekur më lartë.

Parcela P-72614041-00036-2, Tipi i pronës/Lloji i Pronës: Pronë Shoqërore/R; Shfrytëzimi aktual /Kultura-klasa :Bujqësore – Arat – Arë e klasës 3; me sipërfaqe prej 5300 m² ; Pjesa e Pronës 1/1 zk.Llazarevë ;vendi i quajtur:Tërshevina te Llazareva e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 12 vota për dhe 4 vota kundër e miratuan parcelën e cekur më lartë.

Parcela P-72614051-00226-0, Zona:Rural; Lloji i Shfrytëzimit të parcelës :Bujqësore ; Shfrytëzimi aktual i parcelës:Arat; Kualiteti i klasës: Arë e klasës 6 ; me sipërfaqe prej **120229 m²** ; Pjesa e Pronës 1/1; Vendi i quajtur: Jezero; zk.Milloshëvë e cila evidentohet në emër të KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 12 vota për dhe 4 vota kundër e miratuan parcelën e cekur më lartë.

Pika 7 e rendit ditës

Sami Ahmeti – Kërkesa e parë është të paktën këto 2 vendime që i morëm tash, të reja do të thotë 2 Propozimvendimet që ishin shpresoj se nuk janë sekrete të na i dërgoni për shkak se më e pakta që mundemi me bë është se kemi të drejtë edhe me i pasë. Unë i kam 2 kërkesa që po vazhdon të përsëritet te objekti te Hashanët, që ka qenë e paraparë për çerdhe. Ai objekt po ka problem, po ka shqetësime të qytetarëve që po vazhdon të përdoret për çështje të ndryshme që i rrezikojnë të rinjtë. Është mirë që ne si Kuvend Komunal, por edhe Ekzekutivi më në fund me marrë një vendim dhe me ia dhënë një destinacion atij objekti. Ne jemi të gatshëm çkado që ka nevojë me dhënë kontributin tonë sepse nuk është çështje partiake, por është problem që po i shqetëson qytetarët. Kërkesa e dytë është te shkolla te Hashanët, vetë nuk i kam pa kam shqetësime të dy prindërve që thonë se në disa vende instalimi i shkollës kryesisht te ndërpresat është zbulue dhe rrezikojnë jetët e fëmijëve. Është mirë me iu tregue kush merret me atë shkollë, atij drejtori që ndoshta, është informacion që nuk është i saktë, por unë kam informacion prej prindërve. Ndërsa, vetë nuk e kam parë që thuhet se në disa vende prizat janë zbuluar telat dhe rrezikojnë jetët e fëmijëve brenda shkollës, kështu që është mirë të shihet.

